



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 179, Datë, 04.11.2020

“MBI  
KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SH.A., PËR SHTYRJE TË AFATIT TË  
VENDIMARRJES FINALE TË BORDIT TË ERE”.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 16, pika 12, neneve 46 dhe 56 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 116/4 prot, datë 27.10.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- Pas kërkesave të përsërituar të aplikuesit për zgjatjen e afatit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencim, ERE me vendimet nr. 43, datë 06.03.2020 dhe nr. 119, datë 17.07.2020 së fundmi, vendosi për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 10.10.2020.
- Ndërkohë përpara përfundimit të këtij afati, shoqëria “Albgaz” sh.a., ka paraqitur shkresën me nr. 1103 prot, protokolluar në ERE, në datën 12.10.2020 duke kërkuar sërish shtyrjen e këtij afati procedural.
- Kërkesa e “ALBGAZ” sh.a., rezulton e depozituar brënda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili përcakton se:  
*Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik*

*mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.*

- Me anë të kësaj kërkesë shoqëria kërkon miratimin e ERE-s për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes finale për operimin e hapësirave të depozitimit të gazit natyror për “Albgaz” sh.a., deri në datën 20.03.2021, për arsye që lidhen me gjendjen e krijuar nga pandemia COVID-19, e cila ka krijuar vështirësi në përmbushjen e dokumentacionit të munguar për shkak të kufizimeve që vazhdojnë ende dhe që vështirësojnë punën e “Albgaz” sh.a.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a., për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 20.03.2021.
2. Shoqëria “Albgaz” sh.a., të marrë masa për të depozituar në ERE dokumentacionin e munguar, jo më vonë se data 10.03.2021.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palën e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që nga data 10.10.2020.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**